



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.15/2011
Prishtinë, më 08.06.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Mungoi: Ramiz Kelmendi.

Të ftuarit për raportim: Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit ekonomik; Frymëzim Isufaj, Lirond Mavriqi dhe Gëzim Baxhaku- Këshilltar në Ministrin e Zhvillimit Ekonomik- MZHE.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZPRK; Haxhi Gashi-USAID/ Deloitte; Fitim Salihu – KDI; dhe Sanije Berisha - OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i ministrit të ministrisë së Zhvillimit ekonomik të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për zhvillimin ekonomik të vendit, I ftuar ministri Besim Beqaj (Ministër i Zhvillimit ekonomik);
3. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Raportimi i ministrit të ministrisë së Zhvillimit ekonomik të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për zhvillimin ekonomik të vendit, I ftuar ministri Besim Beqaj (Ministër i Zhvillimit ekonomik)

Kryetari – tha se siç është paraparë për këtë pikë të rendit të ditës, është Raportim i ministrit Besim Beqaj të ministrisë së Zhvillimit ekonomik. Ne kemi ftuar z.Beqaj, i cili do të paraqet një ekspozitë të shkurtë për zhvillimin ekonomik të vendit, probleme dhe sfidat e kësaj ministrie.

Besim Beqaj (ministër i Zhvillimit ekonomik) - tha që duke iu referuar shkresës tuaj, të pranuar me datë 06.06.2011, lidhur me raportimin me shkrim para Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për sfidat e Raportit të Progresit, qëndron si në vijim: Projektligji për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është në procedurë të hartimit në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ashtu siç e parasheh Rregullorja e Punës së Qeverisë, me Vendim të Qeverisë është themeluar Grupi Punues Qeveritarë për shqyrtimin e këtij Projektligji. Priten komente nga ICO me qëllim të fillimit të punës së këtij projektligji. Në këtë Grup Punues Qeveritar janë përfshirë ekspertë dhe vëzhgues nga USAID-DELOITTE, ICO dhe EULEX. Procesi i ndërtimit të Termocentralit të ri dhe përshpejtimi i privatizimit dhe transaksioneve. Në fund të vitit 2009 Qeveria publikoi Shprehjen e Interesit për Projektin e ri-konfiguruar:Zhvillimin e termocentralit me djegie nga linjiti deri në 1,000 MW;Zhvillimin e minierës së Linjtit për të siguruar furnizim të Kosovës A, Kosovës B dhe termocentralit Kosova e Re (TCKR); Përfshirja e sektorit privat në termocentralin Kosova e B.Shprehje të Interesit kanë paraqitur 6 konsorciume, duke përfshirë kompani nga 10 vende. Kriteret e para-kualifikimit ishin dizajnuar që të sigurojnë që kandidatët arrijnë pragjet e para-caktuara financiare, teknike, dhe zhvillimin e minierës dhe termocentralit dhe pragjet operacionale. KDP ka vendosur që 4 nga 6 aplikuesit që kanë dorëzuar Shprehjet e Interesit plotësojnë Kriteret e Para-kualifikimit, dhe kanë zgjedhur këta aplikantë për listë të ngushtë të Ofertuesve për Projektin.Katër Ofertuesit janë, sipas renditjes alfabetike: Adani Power / PT Adani Global konsorcium nga India dhe Indonezia; AES Electric Ltd / Demir Export A.S. konsorcium nga SHBA dhe Turqi; Park Holding paraqitja nga Turqi; PPC / ContourGlobal LLP konsorcium nga Greqia dhe UK/SHBA. Me datë 10 Gusht 2010, Qeveria pas rekomandimit të Komitetit Drejtues të Projektit publikoi dhe u dërgoi ofertuesve të para-kualifikuar Draft Kërkesën për Propozime dhe draft Marrëveshjet e Projektit. KDP-ja pranoi komente nga ofertuesit e para-kualifikuar në draft Kërkesën për Propozime dhe në draft Marrëveshjet e Projektit deri me datë 29 Tetor 2010. Prioritet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të shprehura në Vizionin e Zhvillimit Ekonomik 2011-2014, parashohin këto afate për zhvillim të Transaksionit Kosova e Re: Shpallja e fituesit – shkurt 2012; Përmbyllja financiare – tetor 2012 dhe Bartja e aseteve – dhjetor 2012. Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të datës 1

Qershor 2011 morri vendim për ri-konfigurimin e përbërjes së Komitetit Drejtues të Projektit, me qëllim të reflektimit të ndryshimeve të fundit organizative që kanë ndodhur në Qeveri dhe po ashtu zëvendësohet vendimi ekzekutiv i PSSP-së të datës 17 Mars 2006 për themelimin fillestar të Komitetit. Furnizimi i sigurtë me energji elektrike për konsumatorët dhe përmirësimi në faturim dhe inkasim. Indikatorët kryesor (Prodhimi i Energjisë Bruto/Neto) tregojnë një performancë të mirë të kësaj ndërmarrjeje në vitin 2010 me trend pozitiv. Gjatë këtij viti prodhimi i energjisë elektrike ka qenë 5,480,972 MË/h Bruto, ndërsa 4,862,174 MË/h Neto në termocentralet Kosova A dhe B. Në krahasim me vitin 2009, viti 2010 ka pasur një rritje të prodhimit të energjisë elektrike për 4%. Gjithashtu edhe divizioni i mihjeve në KEK ka pasur ngritje të nivelit të prodhimit. Në krahasim me tri vitet e kaluara, viti 2010 ka shënuar rritje të prodhimit të qymyrit nga 6,715,350 ton në 2007 në 7,958,090 ton në vitin 2010. Në krahasim me vitin 2009, divizioni i mihjeve në KEK ka pasur një rritje për 1,52%. Në vazhdim të ngritjeve të prodhimit të energjisë në KEK, edhe divizioni i rrjetit ka pasur gjithashtu ngritje të nivelit të inkasimit. Në vitin 2010, 97.3% është përqindja e leximit të njehsorëve, 98.8% ka qenë shkalla e shpërndarjes së faturave, ndërsa 80.0% ka qenë faturimi i energjisë së disponueshme për shitje ose 96.6% e planit të parapare për vitin 2010. Nga ky faturim, përqindja e inkasimit për vitin 2010 ka qenë 87.9 ose 108.2% si përqindje e realizimit nga plani i parapare i cili ka qenë 81.22%. Divizioni i furnizimit në KEK për vitin 2010 përmbyllet me rritje të shkallës së inkasimit për 11% në raport me vitin paraprak si dhe me zvogëlim të humbjeve për 1.6% po ashtu në raport me vitin paraprak. Korporata Energjetike e Kosovës gjithashtu ndihmohet nga Qeveria e Kosovës për importimin e energjisë elektrike si dhe subvencionohet për rastet sociale për familjet të cilat janë kategorizuar sipas kriterëve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale . Vlera e përgjithshme e këtyre subvencioneve është 31,850,000.00€ për vitin 2010 (27,350,000.00€ për import të energjisë elektrike dhe 4,500,000.00€ për familjet në vështirësi financiare). Masat e ndërmarra për evitimin e pengesave në furnizimin me energji elektrike për bizneset në Kosovë, mungesa e furnizimit të qëndrueshëm me energji për bizneset. Të gjithë konsumatorët e KEK-ut trajtohen njësoj (pa diskriminim) për furnizim me energji elektrike, dallojnë vetëm rastet e mos pagesës. Te bizneset të cilat kanë furnizim me linjë të veçantë prej 10 kV , nuk kanë reduktime për furnizim me energji elektrike por furnizohen në mënyrë të rregullt 24 orë. Sipas të dhënave nga KEK-u janë mbi 100 biznese që kanë lidhje të tillë të veçantë.

Kryetari- theksoj se çështjet që lidhet shpesh me ministrinë e juaj është edhe Dhoma e veçantë në Gjykatën supreme, e cila është paraparë edhe në Strategjinë legjislative të Qeverisë kërkojë një informatë se ku gjendet ky projektligji? Një çështje lidhur me përfaqësimin e komuniteteve në ndërmarrjet publike, sa janë të përfaqësuar? Për çështjen të energjisë ju i dhatë shumë të dhëna të energjia, ka pasur edhe disa të dhëna që ka pasur shumë të interesuar nga investitorët të ndryshëm për investim në këtë drejtim? Në Raportin e progresit Komisioni evropian ka përmendur shfrytëzimin e pakontrolluar të minierave dhe mineraleve, se është interesim i BE-së në këtë drejtim nëse ka ndonjë informacion shtesë inkurajuese në çfarë masash konkrete do të merr Ministria në bashkëpunim edhe me KPMM-n? Për planin kombëtar të shpërndarjes së frekuencave, a përfshin ky plan dhe MZHE- n dhe rrjetin më të avancuar 3G për mundësitë, e konkurrencës më të madhe në këtë drejtim?

Myzejene Selmani - tha se ju potencuat çështjen e plotësimit ndryshimit të ligjit të ndërmarrjeve publike dhe akoma është në funksion një kërkesë nga njësia për monitorim. Çështja e

subvencionit të KEK-ut dhe a japin llogari ndërmarrjet publike te ju si Ministër? Çështja e furnizimit të distribucionit në procesin e ndërtimit të Kosovës së Re duke e mare parasysh se këto dy procese duhet të shkojnë baras njëra me tjetrën kisha dashur z.ministër pak më shumë detaje se çka kishte me ndodhur sikurse këto dy procese të cilat janë në mënyrë paralele njëra me tjetrën, një transparencë nga ana e juaj? Një seancë të radhës pra në një seancë plenare të bëhet më transparent procesi i privatizimit të PTK-së duke e marrë parasysh, ndoshta unë kam qenë një person e cila kam qenë shumë kundër procesit të privatizimit të PTK-së, mirëpo nga një takim i javës së kaluar mund të them se shumë më shpejtë do të privatizohet PTK-ja ku keqpërdorën edhe konsumatorët gjatë pagesës të telefonisë mobile.

Visar Ymeri- kryesisht pyetjet kanë me qenë të ndërlidhura lidhur me privatizimin e PTK-së, ku theksoj se një ndër çështjet të cilat duhet të ngritët sa i përket privatizimit të PTK-së pra pse nuk po shkohet me privatizim gradual të PTK-së, pse nuk po shkohet me shitje graduale të aksioneve e shitje kjo e cila do të ju jepte më shumë gjasa qytetarëve të Kosovës që të marrin pjesë në këtë privatizim, e jo në këtë mënyrë që të ju shitet pjesa më e madhe e aksioneve vetëm një kompanie. Sa i përket këshilltarëve të transaksionit në privatizimin e PTK-së njëri prej tyre i cili ka qenë shumë i afërt me Austria-Telekomin, edhe nëse ky vazhdon të jetë këshilltar i transaksionit, a është shkelje e interesit? Pse po e vazhdoni këtë privatizim me këtë këshilltar kur po e shohim që njëra nga kompanitë të cilat ka punuar ngushtë ka qenë e para-kualifikuar? Te sindikatat e PTK-së, ju a keni bashkëpunim me to sepse janë dy sindikata në PTK apo vetëm me njërën sepse ato dy sindikata nga pak dallojnë me qëndrimet e tyre? Për privatizimin e Distribucionit të KEK-ut, kemi parë që përvoja e vendeve të rajonit të Shqipërisë dhe Maqedonisë është një përvojë që mendoj se duhet të marrim mësim sa i përket këtij privatizimi, a e keni analizua këtë çështje?

Biserka Kostić- Pyeti se a ka shërbime në viset rurale, ku qytetarët apo bujqit mund të informohen lidhur me subvencionet që ndan Qeveria? A keni bashkëpunim me komunat e banuara me popullatë serbe? Sa ka minoritete të përfshira në ndërmarrje publike? Për ndërmarrjet e vogla me projekte të dedikuara punës së tyre të a mund të marrin subvencione ?

Hashim Deshishku - pyeti për Trepçën, lidhur me një ndërmarrës grek dhe ka qenë një marrëveshje me ish Jugosllavinë apo Serbinë, që është bërë një transaksion, ku kemi arrit ne si shtet dhe sa është ajo kontratë valide, edhe a e keni shikuar atë kontratë? Për reduktimet e energjisë elektrike që po bëhen në mënyrë kolektive, a është kjo e drejtë? Sa është kjo e ligjshme dhe kush duhet ti kompensoj demet që i bënë KEK-u konsumatorëve të rregullt që paguajnë energjinë elektrike të shpenzuar?

Sala Berisha Shala - tha njëri ndër segmentet që janë mjaftë të rëndësishme për miniera dhe minerale gjatë raportimit të juaj, në këtë drejtim u përmend inicimi i projektligjit për Trepçën. Kërkoj nga ministria që të jenë një më aktiv sa i përket çështjeve të minierave dhe të mineraleve dhe në përshpejtimin e projektligjeve dhe udhëzimeve administrative. Pyeti çka ka po ndodh me Institutin gjeologjik të minierave edhe Muzeu i kristaleve të minierave, që janë të rregulluara me ligjin e minierave dhe mineraleve dhe sa është duke punuar ministria e Zhvillimit ekonomik për formimin e tyre? Ku ka mbet Strategjia e minierave dhe mineraleve të Kosovës?

Besim Beqaj (ministër i Zhvillimit ekonomik) – u përgjigj në pyetjet e deputetve si në vijim: sa i përket Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, projektligji do të procedohet deri në gjysmën e dytë të këtij muaji në Kuvend. Për KPMM-në, është institucion i pavarur i cili i përgjigjet Kuvendit, normalisht në aspektin operativ funksional të tyre kemi bashkëpunim, mirëpo ata në mënyrë të drejtpërdrejt ju përgjigjen juve dhe në realisht dhe në bashkëpunojmë sepse është çështje e rëndësishme. Kemi një Institut i cili realisht i përgjigjet edhe ministrit por të gjitha veprimet e tyre kalojnë nëpër Parlament, sepse është organ i Parlamentit. Tek tabelat që i përmendet kur e kemi fjalën të frekuencat këtu kemi të bëjmë me

një çështje pra edhe ART-ja është Agjencion i pavarur i cili prapë i përgjigjet Kuvendit. Lidhur me ndryshimin dhe amendamentimin e Ligjit për ndërmarrjet publike procesi ka filluar po ashtu me komunat dhe me ministrinë e pushtetit lokal kemi pasur disa takime deri më tani dhe mendojmë që duhet ne që brenda këtij viti ta qartësojmë. Te ndërmarrjet publike te furnizimit me ujë edhe dhe te ndërmarrjet të cilat merren me pastrimin e mbeturinave janë kompetenca në nivel lokal, shqetësimi ynë është që bartja e kompetencave nënkupton edhe bartjen e obligimeve financiare dhe ne ju kemi thënë se ne jemi plotësisht të pajtimit që jo vetëm me i bartë kompetencat por edhe obligimet financiare të mbesin me buxhetin. Sepse ne e bëjmë subvencionimin në investimeve kapitale në secilën komunë veç e veç ne e kemi një sasi të mjeteve të caktuara të cilat brenda vitit si ministri i ndajmë për ti subvencionua edhe investimet kapitale, por në shumicën e komunave vlejnë tasteve administrative nuk janë të vetëqëndrueshme. Tek subvencionimet e ndërmarrjeve publike kemi njësinë e cila merret me këtë monitorim dhe jemi jashtëzakonisht striktë në këtë. Në subvencionin kryesor e kemi KEK-un është me 27.3 milion ne në të njëjtën ditë në vitin 2008 bie në mënyrë drastike. Ne kemi rreth 47 % humbje teknike duke e përfshirë 15% dhe të tjerat të cilat janë humbje komerciale dhe mund të them se kjo është një problem serioz të cilën realisht ne e kemi sa i përket kësaj por qëllimi jonë është që ta fillojmë një proces të mirëfilltë në nivel të ndërmarrjes. Ajo çka ka ndodh është se te ndërmarrja Kosova e Re ne e kemi një proces i cili ka ndodh në të kaluarën, edhe ne jemi duke e rishikuar atë proces edhe në aspektin legjislativ sepse KEK dhe Kosova e Re duhet me ble rrymë nga publiku por në të ardhmen nga kompania private. Sepse njëra flitet për privatizim, ndërsa te Kosova e Re nuk flitet për privatizim pra kjo është dallim shumë i madh sepse të privatizimi i KEK-it kemi privatizim të shërbimeve dhe të aseteve të cilat bart ndërsa te Kosova e Re, kemi asetet shtetërore dhe duhet të jemi shumë më të kujdesshëm sepse po flasim si hyrje si aksionarë në këtë proces. Tek PTK-ja si proces, jam i gatshëm ku të doni të flas edhe në Parlament, vendimi në Parlament është marrë këtu ka ekzistuar një strategji e cila ka kaluar në Parlament me legjislativin paraprak, kjo storje ka fillua në vitin 2007 dhe normalisht janë marrë vendime të ndryshme dhe kemi një strategji e cila ka filluar nga Parlamenti dhe ne jemi ne zbatim të asaj strategjie. Te sindikatat ne kemi bashkëpunim me të dy sindikatat edhe më njërën edhe më tjetrën, i kam njoftuar në takim te dyja sindikatat dhe në asnjë moment dhe nuk ka asnjë kërkesë zyrtare nga ana e sindikatave për atë takim të cilat i kam ftuar e dyja. Nëse kërkesa e tyre është me i humbë kontratat por e them me e miratuar kërkimin e pagave për pesë vite dhe garantim për mos me ju ndryshuar vendi i punës dhe kjo është dëmtim i drejtpërdrejt i transaksionit që kushton në transaksion hiq më pak se 60 milion euro sepse 30 milion është kostoja edhe 30 milion janë shtesë. Sa i përket këshilltarit të transaksionit si proces këta këshilltar të transaksionit janë përzgjedhë në bazë të një reference ndërkombëtare ka qenë një proces i hapur ndërkombëtar kanë qenë temat e referencës. Lidhur me Trepçën, nuk po flasim për asnjë kontratë e cila është bërë në mënyrë jo ilegale pra të gjitha këto kontrata janë bërë në mënyrë ilegale pra çdo kontratë e tillë vlerësohet nga këshilli shtetëror dhe me rregullore e cila është aprovuar në fillim në rregulloren e UNMIK-ut dhe ajo i ka fuqizua të gjitha transaksionet që kanë ndodh dhe ne sillemi konform saj. Ndërprerjet kolektive të energjisë nuk janë të mira, ajo është e vërtet, ata kanë një marrëveshje me Ministrinë për asistim aty ku nuk paguhet në Ministrinë e Punëve të brendshme në bazë të asistencës por kjo që po tentohet, është që të gjitha këto parregullsi të eliminohen në mënyrë sa më të madhe, por nga ana e biznesit të cilët e drejtuat nga ana e juaj mund të them që së shpejti në KEK do të krijohet një njësi e cila merrte me këtë çështje teknike apo probleme teknike. Zbatimi i ligjit për miniera dhe minerale, do të isha shumë i gatshëm sepse kjo është në bashkëpunim me KPMM-në. Ndërsa sa i përket aftësimin të komuniteteve këtu e keni në dokumentin të cilin ju kemi dhënë tek punësimi i qytetarëve dhe kjo nënkupton kështu në kompanitë publike i kemi 227 serb të punësuar 131 boshnjak 4 romë dhe 37 turq, normalisht i tejkalon përqindjet entiteteve në Kosovë.

Konkluzion

Ministrat e linjave përkatëse do të ftohen të raportojnë ne Komision, për punën e tyre dhe për plotësimin e sfidave të evindetuara nga Raporti i Progresit.

5. Të ndryshme.

Aktivitet e radhës te Komisionit;

Kryetari – i njoftoi anëtarët e Komisionit që datë 09.06.2011 do të vizitojnë Trepçën, për një takim punë rreth aktiviteteve dhe funksionimit të Trepçës. Me datë 10.06.2011 do kemi Dëgjim publik për Planin kombëtar për shpërndarjen e radiofrekuencave. Ndërsa më datën 13.06.2011, në bazë të Planit të punës Vizitë pune në Ministrinë e infrastrukturës me qëllim të mbikëqyrjes dhe njohjes me aktivitetet e Ministrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit